

A low-angle, upward-looking perspective of a modern skyscraper with a glass facade. The building's structure creates a series of converging lines that lead the eye towards the top of the frame. The sky is visible through the opening at the top, showing a light blue color with some soft, white clouds. The overall tone is professional and architectural.

Raport i Transparencēs 2023

EURO-AUDIT CONSULTANCY, CO



Përmbajtja

1.	Hyrje	1
2.	Struktura ligjore	2
3.	Struktura drejtuese e shoqërisë dhe shpërblimi i partnerëve.....	3
4.	Politikat e sistemit të kontrollit të cilësisë.....	4
5.	Deklarata e praktikave të pavarësisë së shoqërisë audituese.....	6
6.	Politika për edukimin dhe kualifikimin e vijueshëm profesional.....	7
7.	Informacioni financiar.....	9
8.	Lista e Njësive Ekonomike me Interes Publik.....	10



Hyrje

Kemi kënaqësinë t'ju paraqesim raportin e transparencës të shoqërisë audituese “Euro – Audit, Consultancy, Co ” Sh.p.k Tiranë për vitin 2023. Me një eksperiencë 16 vjecare në tregun shqipëtar, Euro-Audit, Consultancy, Co, u zhvillua si një shoqëri e suksesshme në fushën e auditimit, konsulencës dhe shërbimeve financiare. Personeli i kualifikuar ka përvojë të gjerë pune në ndërmarrjet që operojnë në industri të ndryshme në tregun Shqiptar.

Suksesi ynë i vazhdueshëm mbështetet në përvojën tonë të gjerë e cila, së bashku me stafin tonë, formon bazën e aftësisë për të ndihmuar çdo klient në mënyrën më të mirë të mundshme.

Ne punojmë ngushtësisht me stafin drejtues të klientëve për të kuptuar më mirë vështirësitë që këto organizata kanë dhe më pas marrim një rol aktiv në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme.

Ne jemi të dedikuar për t'i shërbyer kërkesave të klientëve në sektorin privat, shoqërive të listuara dhe shoqërive në sektorin publik , përmes ofrimit të një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe këshillimit kontabël e financiar.





Struktura ligjore

Euro – Audit, Consultancy, Co Sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Shqipëri në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14.04.2008. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga z.Paqësor Qato në masën 90%, z.Armand Hasko në masën 5% dhe znj.Eva Basho në masën 5%.

Shoqëria administrohet nga z.Paqësor Qato, ortak i shoqërisë si dhe Auditues Ligjor i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Pjesë e shoqërisë janë dy Auditues Ligjorë të rregjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Republikën e Shqipërisë:

- Z. Paqësor Qato
- Z. Armand Hasko



Shoqëria audituese **Euro–Audit, Consultancy, co Sh.p.k.** është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 03.12.2008 dhe ka një eksperiencë 16 vjecare në tregun e auditimit, shërbimeve kontabël dhe fiskale si dhe këshillimeve financiare.

Ne jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë profesionale cilësore dhe të përsosmërisë së etikës. Ne kemi synimin dhe përkushtimin tonë të motivojmë stafin për të arritur standardet më të larta të sjelljes dhe performancës.



Struktura drejtuese e shoqërisë dhe shpërblimi i partnerëve

Shoqëria **Euro – Audit, Consultancy, Co Sh.p.k** administrohet nga z. Paqësor Qato, ortak i shoqërisë si dhe Auditues Ligjor i regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

Ne jemi të fokusuar në ofrimin e një game të gjerë shërbimesh të auditimit, taksave dhe konsulencës.

Shpërblimi i partnerëve

Partnerët e shoqërisë shpërblehen me pagë, bonuse performance për arritje dhe përmbushje objektivash si dhe dividendë të shpërndarë në përputhje me vendimarrjet e vetë shoqërisë .

Struktura e shërbimeve profesionale të ofruara nga **Euro – Audit, Consultancy, Co Sh.p.k.** është si vijon:

- ❖ Shërbime të Auditimit Ligjor dhe Dhënies së sigurisë
- ❖ Shërbime konsulence financiare dhe fiskale
- ❖ Shërbime të kontabilitetit, mbajtjes së llogarive
- ❖ Hartim i Pasqyrave Financiare
- ❖ Aktivitete të Këshillimit Ekonomik
- ❖ Procedura të Due Diligence
- ❖ Shërbime për konsulencë për riskun e biznesit
- ❖ Bashkime, ndarje, transferime të shoqërive tregtare
- ❖ Shërbime të tjera profesionale ne fushën e Auditimit dhe Kontabilitetit



Politikat e sistemit të kontrollit të cilësisë

Pavarësia dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga shoqëria janë faktorë shumë të rëndësishëm për të ardhmen e aktivitetit. Qëllimi ynë është të vendosim sisteme rigoroze të cilësisë të dizenuar për të na dhënë siguri të arsyeshme që shoqëria dhe punonjësit e saj të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë.

Prandaj, ne kemi hartuar dhe implementuar një sërë politikash dhe procedurash në lidhje me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe proceset e kontrollit të brendshëm, masat e vlerësimit të riskut dhe sistemet e monitorimit që sigurojnë që të gjithë ne jemi në përputhje me standardet e larta që kemi vendosur - standardet që klientët tanë presin.

Shoqëria ka procedura rigoroze të menaxhimit të cilësisë, të cilat përfshijnë:

- Manualet teknike dhe proceduriale - për të siguruar që shërbimi të ofrohet në mënyrë të vazhdueshme me standard të lartë;
- Trajnim dhe zhvillim të vazhdueshëm të të gjithë partnerëve dhe punonjësve; vlerësim vjetor të të gjithë stafit;
- Etika dhe integriteti; ne pranojmë/vijojmë t'ju ofrojmë shërbime vetëm klientëve që demonstrojnë integritet;
- Kjo arrihet përmes vlerësimit të parametrave relativë që kanë të bëjnë me pranimin dhe vijimin e klientëve (Pranimi & Vijimi i Marrëdhënieve me Klientë & Politikat dhe Procedurat e Angazhimeve Specifike të Auditimit)
- Rishikimi i proceseve të cilësisë së shërbimeve të sigurisë për të mundësuar që drejtimi të fitojë siguri se ekzistojnë procedurat e nevojshme, janë duke funksionuar dhe janë efektive (Rishikimi i Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë - "SNKC1")
- Aftësitë dhe cilësitë personale të partnerëve dhe punonjësve dhe përputhshmëria e tyre me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të IFAC (Kërkesat Etike)



- Kryerja e auditimeve në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore për raporte cilësore të auditimit;
- Objektiviteti dhe pavarësia - kuptimi nga e gjithë shoqëria se reputacioni ynë i fituar me vështirësi varet nga cilësia e punës sonë dhe nga cilësia e vendimeve që ne marrim.

Shoqëria jonë adopton një kuadër të menaxhimit të riskut ku drejtimi është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të kryera dhe siguron zbatimin e procedurave të përshtatshme në baza vjetore. Përmes identifikimit të dobësive të mundshme, merren masa të përshtatshme për të monitoruar plotësisht proceset e kontrollit.





Deklarata e pavarësise së audituesit

Euro-Audit, Consultancy, Co Sh.p.k. ruan politika dhe procedura të shkruara mbi pavarësinë, ndër të cilat përfshihet edhe kryerja e disa kontrolleve të pajtueshmërisë së pavarësisë në baza vjetore, për të garantuar zbatimin dhe respektimin me rigorozitet të Kërkesave të përcaktuara në Kodin Ndërkombëtar të Etikës.

- ✓ Çdo profesionist duhet të nënshkruajë një konfirmim individual mbi pavarësinë, vit pas viti. Përveç kësaj, konfirmime të kësaj natyre mbi pavarësisë janë përshtatur gjithashtu për punonjësit e rinj si dhe ato të larguar nga Shoqëria.
- ✓ I gjithë stafi menaxherial si dhe stafi i profesionistëve të lartpërmendur duhet të përfshijnë interesat e tyre financiare në një sistem global të monitorimit të pavarësisë. Portofoli i çdo personi kontrollohet kundrejt një liste elektronike të klientëve të auditit për të parë nëse ndodhemi në kushtet e ruajtjes dhe mos kompromentimit të pavarësisë;

Përveç monitorimit të vazhdueshëm të pajtueshmërisë me politikat e pavarësisë, inspektime të pavarësisë dhe procedura të testimit kryhen çdo vit, për të evidentuar në kohë kërcënimet ndaj pavarësisë, analizën e natyrës së tyre si dhe eliminimin e tyre në masën dhe mënyrën e nevojshme.





Politika për edukimin dhe kualifikimin e vijueshëm profesional

Edukimi i vazhdueshëm është një politikë kyç e shoqërisë, pasi ky është një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e njohurive, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve tona.

Si një shoqëri shërbimesh profesionale që ofron një gamë të plotë të shërbimeve të auditimit, të kontabilitetit dhe konsulencës, është thelbësore që cilësia dhe profesionaliteti të jetë në themelin e çdo shërbimi të ofruar për klientët tanë, duke përmbushur me sukses pritshmëritë e tyre. Kritike për suksesin tonë në arritjen dhe ruajtjen e standardeve tona të cilësisë, janë kualifikimet profesionale dhe trajnimet e audituesit ligjor dhe të stafit mbështetës në procesin e auditimit.

Ekipi ynë angazhohet në një strukturë që promovon një kulturë të trajnimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit profesional përmes procesit të menaxhimit të performancës me fokusin kryesor në arritjen e ekspertizës teknike dhe përsosmërisë.



Profesionistët e shoqërisë informohen dhe trajnohen rregullisht mbi ndryshimet e fundit në lidhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Legjislacionin fiskal dhe kuadrin ligjor tregtar të zbatueshëm. Trajnimet vjetore të përditësimit të njohurive në fushën e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar janë të detyrueshme për të gjithë stafin profesional të Auditimit Ligjor.



Programi i edukimit të vazhdueshëm është i përbërë nga sesione trajnimi të organizuara nga Euro-Audit Consultancy,co Sh.p.k. si dhe trajnime të ndryshme të ndërmarrë nga organizma të njohur profesionalë.

Trajnimi dhe zhvillimi profesional i punonjësve tanë është i rëndësishëm për suksesin e biznesit tonë dhe aftësinë tonë për të siguruar që cilësia është e lartë në të gjitha fushtat tona të shërbimit. Filozofia jonë e zhvillimit bazohet jo vetëm në trajnime formale, me mësim në vendin e punës por edhe në nivele të rëndësishme të edukimit të vazhdueshëm profesional.





Informacione financiare

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria audituese “Euro – Audit, Consultancy, Co ” Sh.p.k për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë si në vijim :

Shërbime	Të ardhurat në "mijë lekë"
Auditim Ligjor	11 718
Angazhime të tjera	7 399
Totali	19 117





Lista e Njësive Ekonomike me Interes Publik

Lista e njësive ekonomike me interes publik për të cilat Euro Audit, Consulancy,Co Sh.p.k ka lëshuar një opinion të auditimit të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është dhënë në vijim.

Përkufizimi i një njësie ekonomike me interes publik për këtë qëllim është ai i dhënë sipas ligjit Nr. 10 091 datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar .

“Njësi ekonomike me interes publik” janë:

- Të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë;
- Bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jo banka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- Shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave



Gjatë vitit 2023 shoqëria **Euro – Audit, Consultancy, Co Sh.p.k.** kreu auditimin për entitetet me risk publik te detajuara si në vijim :

- Rofix Sh.p.k
- PSZ Albania GmbH Sh.p.k
- University of New York Tirana Sh.p.k
- Trimed Sh.p.k
- Kadiu Sh.a
- EKMA Albania Sh.p.k
- Time 10 Sh.p.k
- Kastrati Construction Sh.p.k
- Continental Group Sh.a
- Tomaificio Bama Sh.p.k
- Ujesjelles Kanalizime Libohove Sh.a
- Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster Sh.a
- Siame Sh.p.k